



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2020:139632

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05427653

**C.nr.887/20**

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Zenel Tasholli, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arta Shaqiri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F. A. nga fsh. G., K. L., të cilin e përfaqëson av. Naser Gashi me seli në L., kundër të paditurës B. K.e S.. me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson N..D., për shpërblim dëmi, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt. 05.12.2023, në prani të të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit F..A. nga fsh. Gumnasellë, K.Lipjan dhe **DETYROHET** e paditura B.K.e S.me seli në P...për dëmin e pësuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 14.06.2020, t'ia kompensoj dëmin si në vijim:

I.a) Në emër të dëmit jo material t'ia paguajë shumat si vijon:

- Për dhimbje fizike, shumën prej.....6,500.00.-€;
- Për frikën e shkaktuar, shumën prej.....5,500.00.-€;
- Për dhimbjet shpirtërore për shëmtim trupor, shumën prej.....3,500.00.-€;
- Për zvogëlim të aktivitetit jetësor, shumën prej..... 5,000.00.-€;

I.b) Në emër të dëmit material t'ia paguajë shumat si vijon:

- Për ndihmën dhe kujdesin e huaj, shumën prej.....108.08.-€;
- Për ushqim të sforcuar, shumën prej.....227.50.-€;
- Për shpenzimet e mjekimit, shumën prej.....234.00.-€;

Shumës së përgjithëshme-totale do ti zbritjet shuma e paradhënies prej 1,000.00€. Të cilën ia ka paguar e paditura paditësit.

I.c) Në emër të zvogëlimit të aktivitetit punues – fitimin e humbur për periudhën nga dt. 14.06.2020 e deri më dt. 31.10.2023 si datë e përpilimit të ekspertizës, shumën e arritur prej 3,592.00€ si dhe për periudhën e ardhshme që nga dt. 01.11.2023, e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore përkatësisht deri në arritjen e moshës 65 vjeqare paditësi për pension, rentën nga 40.53-€ në muaj ose në formë të kapitalizuar për këtë periudhë shumën e përgjithshme prej 9,775.80-€;

Të gjitha këto shuma në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm, këto me kamatë ligjore prej 8% në vit, dhe atë: për dëmin jo material kamata ligjore rrjedh nga data e marrjes së këtij aktgjykimi 15.12.2023, ndërsa për kategoritë tjera të dëmit material si në pikën I.b) dhe I.c të dispozitivit, kamata ligjore rrjedh nga data e parashtrimit të padisë dt: 21.10.2020, e të gjitha këto gjerë në përmbushjen përfundimtare të detyrimit.

**II. DETYROHET** e paditura t'ia paguajë paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës shumën prej 3,278.80.-€, në afatin prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

**III. REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, si e pabazuar.

### **A r s y e t i m**

#### *Çështja gjyqësore*

Paditësi F.A..përmes të autorizuarit të tij, më dt. 21.10.2020, ka parashtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës B. K.e S..me seli në P.., me objekt kontesti shpërblim dëmi.

#### *Pretendimet e palëve ndërgjyqëse*

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij në padi ka theksuar se me dt. 14.06.2020, në ora 19:20, është shkaktuar aksidenti i komunikacionit nga mjeti bujqësor A, me të dhënat e tjera dhe përshkrim të aksidentit si në raportin e aksidentit të Policisë së Kosovës. Me këtë rast paditësi ka pësuar lëndime trupore në formë të dhimbjeve fizike të intensitetit të ndryshëm, shëmtim, frakturëtë murit të përparmë dhe të pasmë të sinusit frontal, katër intervenime kirurgjike maksillofaciale dhe frikë të intesitetit të ndryshëm.

E paditura në përgjegje në padi, të dt. 04.05.2022, nuk e ka kundërshtuar bazën juridike të padisë, por kontestuese mbetet lartësia e kërkesëpadisë, për faktin se shumat e kërkuara nuk janë të mbështetura në gjendjen faktike dhe nuk janë të argumentuara me prova. Në të njejtën kohë palës paditëse i ka ofruar shumën prej 4,500.00-€, në emër të të gjitha kategorive të dëmit

material dhe jomaterial të shkaktuar në aksidentin e dt. 14.06.2020 si dhe shpenzimet e procedurës. Në rast se i padituri nuk pranon ofertën e dhënë e paditura ka propozuar që gjykata ta refuzoj kërkesëpadinë mbi shumën e ofruar.

Gjykata ka caktuar seancën gjyqësore, në të cilën për paditësin, me autorizim ka prezentuar avokat N. G., ndërsa për të paditurën, me autorizim ka prezentuar Nexhmedin Demolli.

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e dt. 05.12.2023, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë dhe ka kërkuar nga gjykata që të detyroj të paditurën që t'ia paguja paditësit në emër të dëmit jomaterial për dhembjet fizike shumen prej 9.000€, për frikën shumën prej 7.500€, për shëmtim trupor shumën prej 3.500€, për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumen prej 6.500€, në mëer të dëmit material dhe ate për ndihmen dhe kujdesin e huaj shumen prej 350.00€, për ushqim të sforcuar shumen prej 350.00€, për shpenzime të mjekimit shumen prej 831.50€, e në shumë totale prej 27,031.50.€ duke i zbritur shumen prej 1.000€ si zbritje e paradhënies, ndërsa në emër të zvogëlimit të aktivitetit punues punues-fitimin e humbur –fitimin e humbur për periudhën nga dt. 14.06.2020 e deri më dt. 31.10.2023 si datë e përpilimit të ekspertizës, shumën e arritur prej 3,592.00€ si dhe për periudhën e ardhshme që nga dt. 01.11.2023, e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore përkatësisht deri në arritjen e moshës 65 vjeqare paditësi për pension, rentën nga 40.53-€ në muaj ose në formë të kapitalizuar për këtë periudhë shumën e përgjithshme prej 9,775.80-€.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit ka deklaruar se edhe më tutje mbesin pranë kërkesëpadisë të precizuar me parashtrësë dhe deklarimeve në seancat e mbajtura. Nga provat të cilat u administruan në mënyrë të mjaftueshme është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë dhe posaqërisht fakti se e paditura është përgjegjëse për mbulimin e shpërblimit të dëmit si pasojë e lëndimeve të pësuarra paditësit në aksidentin e komunikacionit ku vozitësi i traktorit nuk ka pas policë të sigurimit. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit të bazuar për të gjitha kriteret të cilat i kanë specifikuar në parashtrësën e dt. 05.12.2023, duke obliguar të paditurën të ia kompensoj të gjitha format e dëmit paditësit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas TOAK-së.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i të paditurës ka deklaruar se pas administrimit të provave është vërtetuar fillimisht se ka ndarje të përgjegjësisë dhe se edhe paditësi ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit. Gjykatës i ka propozuar që gjatë marrjes së vendimit të aprovoj shumën të kompensimit, jo më të larta se sa ka ofruar e paditura gjatë këtij procesi gjyqësor kontestimor në shumë prej 11,000.00€. Ka shtuar se e kundërshtojnë precizimin e kërkesëpadisë për shkak se shumën e kërkuara janë tepër të larta dhe nuk janë në harmoni me lëndimet të cilat

paditësi i ka pësuar dhe nuk janë në harmoni as me praktikën e deritanishme gjyqësore për të gjitha pika e kërkuara, ndërsa sa i përket dëmit material – fitim i humbur për të njejtën gjykatës i ka propozuar ta refuzon në tërësi si të pabazuar për shkak se në bazë të provave të prezentuara paditësi është duke punuar dhe gjeneruar të ardhura siq kishte gjeneruar edhe para aksidentit. Prandaj çdo vendim gjyqësor që të njejtit ti njihet fitim i humbur do të ishte pasurim i pabazë për paditësin dhe vendim joligjor. Sa i përket shpenzimeve të kërkuara të njejtat kanë kërkuar që gjykata ti gjykoj sipas suksesit në procedurë.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova: letërnjoftimi i paditësit me nr.1301S; raporti i aksidentit nr. 2020 AR..., dt. 14.06.2020; fletëlëshimi me nr. të historisë 277/20, dt. 25.06.2020, lëshuar nga QKUK – Klinika e K..M...; Raporti mjekësor dt. 30.06.2020, në emër të paditësit, lëshuar nga QKUK - Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale; Raporti specialistik dt. .. lëshuar nga Poliklinika Stomatologjike Kirurgjike "..."; Raporti Qendrës Diagnostike "H..." e dt. 28.07.2020, për paditësin; Raporti i vizitës dt. 29.06.2020, lëshuar nga Spitali R.. M...; Raporti nr.29861, dt. 14.06.2020, lëshuar nga Sherbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – Klinika Emergjente në P...; Raporti specialistik Klinika e R...QKUK P..., dt. 14.06.2020; Certifikata e lëshuar nga ARBK për biznesin DPZ T...; Certifikata e regjistrimit të Biznesit me nr. ..., dt. 12.04.2016, për DPZ T...; Kërkesa për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, dt. 10.08.2020, drejtuar BKS me seli në Prishtinë; Ekspertiza e Komunikacionit rrugor PP.II.nr.3020/20, përpiluar nga eksperti A. K.. në çështjen penale; Ekspertiza e Komunikacionit dt. 02.01.2023, e ekspertit S.. B...; Ekspertiza mjekësore dt. 17.03.2023, e ekspertëve dr. Mergime Prekazi Logja – kirurg maksillofacial, dr. Vjollca Binçe – ortoped traumatolog, dr. S..B.. – psikiatre; Procesverbali i dt. 14.06.2023, në të cilën është bërë administrimi i provës përmes dëgjimit të ekspertes dr. V..B.. dhe ekspertes mjekësore dr. M.. P..L...; Ekspertiza e ekspertit mjeko-ligjor dr. A.. T..., dt. 15.08.2023; Procesverbali i dt.17.10.2023, në të cilën është bërë dëgjimi i ekspertit dr. A..T...; ekspertiza nga lëmia e sigurimeve, aktuaristikës dhe financave C.nr.887/20, dt. 15.11.2023, e ekspertit A..B..., Procesverbali i dt. 16.11.2023, në të cilën është bërë nxjerrja e provës përmes dëgjimit të ekspertit financiar A..B.. si dhe parashtesa për precizimin e kërkesëpadisë e dt. 05.12.2023.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike i autorizuari i paditësit ka propozuar që të caktohet eksperti përkatës nga lëmia e komunikacionit. Eksperti Sejdi

Berisha, në ekspertizën e përpiluar me shkrim të dt.02.01.2023, ka konstatuar se, sa i përket aksidentit të shkaktuar me dt.14.06.2020, i cili ka ndodhur rreth orës 19:20, në mes të Traktorit të markës IMT dhe tipit ..., i cili në kohën e aksidentit kishte qenë pa mbulesë sigurimi, të cilin e drejtonte B.Z.. dhe automjetit të markës VW dhe tipit G..., me targa 03-..., i siguruar, të cilin e drejtonte F.. A., deri të aksidenti i trafikut kishte ardhur kur ngasësi i traktorit “A” duke u kyçur në rrugë, ka filluar të kaloj përmes shenjës STOP nëpër rrugë kryesore nacionale dhe e ka penguar automjetin “B”, pastaj automjeti “B” në momentet e rrezikshme ka filluar të kthehet majtas dhe është shkëputur nga rruga.

Sipas mendimit të ekspertit shkaktar i këtij aksidenti të trafikut është ngasësi i traktorit A është shkaktar i aksidentit duke bërë kyçje të pasigurt nga rruga dytësore (sipas shenjës së trafikut) në rrugën kryesore si dhe me mosdhënien e përparësisë së kalimit automjetit “B”, kurse shoferi i automjetit “B” ka dhënë kontribut në aksident duke pasur shpejtësi jo-adekuate sipas rregullave, kushteve dhe rrethanave në komunikacion.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të dt. 14.06.2023, eksperti gjyqësor i komunikacionit S.B., duke u përgjigjur në pyetjet e parashtruara nga i autorizuari i paditësit ka theksuar se me rastin e aksidentit automjeti “B” nuk ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit por i njejtë është konstatuar se ka lëvizur më shumë se sa kufizimi i shpejtësisë dhe me këtë shpejtësi sipas ligjeve mekanike ka kontribuar në rritjen e vëllimit të dëmit.

Në ekspertizën mjekësore të përpiluar me shkrim nga ekspertet mjekësore dr. Mërgime P.L. – kirurg maksillofacial, dr. V..B.– ortoped-traumatolog dhe dr. S.. B.. – psikiatre, kanë konstatuar se paditësi ka pësuar lëndime plagë shqyese në regjionin ballor, frakturë multifragmentare e murit të përparëm të sinusit frontal me përfshirje edhe të kockës nazale, frakturë e murit të përparëm lateral dhe të pasëm të sinusit maxillar majtas, frakturë e harkut zigomatik të majtë, frakturë e murit të përparëm dhe lateral të sinusit maxillar djathtas, frakturë e maxillës – pallatum durum dhe frakturë e kockës nazale si dhe ndrydhje e regjionit të qafës duke shtuar se këto lëndime konsiderohen si lëndime të natyrës së rëndë trupore.

Të njejtat kanë dhënë vlerësim mjekësor se sa i përket dhembjeve fizike paditësi ka pasur dhembje të intensitetit posaçërisht të rëndë për rreth një orë (duke marrë parasysh vendndodhjen e aksidentit, transportin dhe realizimin e ekzaminimeve klinike, radiologjike dhe marrjen e analgjetikëve në Qendrën Emergjente); dhembje të intensitetit të rëndë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 3 ditësh (e shprehur me dhembje në regjionin e fytyrës duke përfshirë edhe intervenimin kirurgjikal në kockat e fytyrës); dhembje të intensitetit të mesëm për 28 ditë të tjera (që përfshinë priudhën e ramjes së edemës dhe hematomës në regjonet e kockave të thyera); si dhe dhembje të intensitetit të ulët që i posedon ende në hapkë të gojës dhe ndërrime klimatike.

Sa i përket frikës paditësi ka pësuar frikë primare në kohëzgjatje prej disa sekonda në momentin e aksidentit e prezentuar në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimit direkt për integritetin e tij trupor, frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur 24 orë që është manifestuar me simptome të ankthit të gjeneralizuar, frikë nga invaliditeti, çrregullim gjumi, rikujtime të shpeshta të ngjarjes dhe simptome përcjellëse të reagimit akut ndaj stresit, frikë sekondare me intensitet mesatar dhe të ulët që ka zgjatur 3 deri në 4 muaj e manifestuar me reagim eemocionale të karakterit ansioz, zgjime të herë pas hershme gjatë gjumit me rikujtime të ngjarjes traumatike si dhe frikë të intensitetit të ulur të cilën e ka sot e kësaj dite e shoqëruar me pasiguri ndër pjesëmarrje në komunikacion.

Sa i përket zvogëlimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësor është në shkallë prej 15% për shkak të lëndimeve deformuese në fytyrë me pengesa funksionale, deformime traumatike pas thyerjes së kockave të fytyrës, ku pacienti poashtu ka parestezion (mpirje) në regjionin e ballit për shkak të lëndimit të nervit supratrohlearë (nerv sensorik).

Duke vlerësuar kështu se te paditesi ekziston shemtimi i shkallës së mesme për shkak të cikatrikseve postoperative në regjionin e ballit me gjatësi 4cm dhe regjionin lateral të orbites së anës së majtë me gjatësi 2cm, ku kanë vlerësuar se paditesi duhet ti nënshtrohet intervenimit të sërishëm kirurgjikal për heqjen e 6 pllakave të osteosintezës të cilat do ti shprehin edhe më tej cikatrikset.

Në konstatim të mëtutjeshëm kanë vlerësuar se Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 5 javë dhe atë ushqim i pasur me proteina, minerale, vitamina më shumë se ushqimi i zakonshëm dhe ushqim i posaçëm – i lëngshëm për shkak të plagëve në goje. Kurse ndihma dhe kujdesi mjekësor nga personi tjetër ka qenë i nevojshëm për 2 javë duke përfshirë edhe kontrollat mjekësore. Ndërsa, rehabilitimi klimaterik dhe psikofizik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 14 ditësh për vitin e parë për forcimin e muskujve të regjionit të qafës pas lëndimit.

Në seancën e dt. 14.06.2023, ekspertja mjekësore Dr. M. P.L., ka sqaruar se pas ekzaminimit klinik, pas intervenimit kirurgjik si dhe në bazë të dokumentacionit klinik për sa i përket shërimit dhe rikuperimit të kockave të fytyrës intervenimi është kryer me sukses dhe pacienti nuk do të ketë pasojë sa i përket eshtrave, meqenëse ka anestezion të lëkurës së regjionit të ballit për shkak të lëndimit të nervit në atë regjion është pikëpyetje se a do të kthehet sensibilitet apo do të mbetet i tillë, për sa i përket indeve të buta nevojitet në disa qasje e sërishme apo intervenim i sërishëm kirurgjik për largimin e pllakave të osteosintezës, kurse sa i përket lëndimeve të cilat i ka pësuar pacienti dhe pasojat të cilat kanë mbetur nga lëndimi nuk ndikojnë në ushtrimin e profesionit.

Në ekspertizën mjekësore të përpiluar me shkrim nga eksperti mjekësor nga lëmia e mjekësisë së punës dr. A.T. – ortoped-traumatolog, i njejtë sa i perket zvogëlimit të aftësisë punuese ka japur mendim dhe ka konstatuar se diagnoza për paditësin përfshinë frakturë multifragmentare e murit të përparëm të sinusit frontal me përfshirje edhe të kockës së hundës, frakturë e murit të përparëm lateral dhe të pasëm të sinusit maksilar majtas, frakturë e harkut zigomatik të majtë, frakturë e murit të përparëm dhe lateral të sinusit maksilar djathtas, frakturë e maksilës – pallatum durum dhe frakturë e kockës së hundës, plagë shqyese në regjionin ballor dhe ndrydhje të regjionit të qafës duke konstatuar se këto lëndime kualifikohen si lëndime të rënda trupore dhe për pasojë kanë shkaktuar zvogëlim të aktivitetit (aftësisë) të përkohshëm dhe të përhershëm punues, pasi i padituri është flokëtarë, dhe atë: 1. Zvogëlim i përkohshëm i aktivitetit punues: për 3 muaj pas aksidentit në shkallë prej 100% (në të gjitha llojet e punëve, pasi ka qenë i hospitalizuar, rehabilitim të domosdoshëm pas ndërhyrjeve kirurgjikale, fillimi i rehabilitimit fizioterapeutik, ordinimi i terapisë kundër dhimbjeve, pushimi i detyruar), për 6 muaj të tjerë pas aksidentit në shkallë prej 50% (kjo periudhë përfshinë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që janë të nevojshme për të ushtruar profesionin e tij (me duar dhe qëndrim në këmbë) pozita të papërshtatshme dhe të detyruara të qafës gjatë ushtrimit të profesionit); si dhe 2. Zvogëlim i aktivitetit të përhershëm punues: i cili ekziston në shkallë prej 10% (për ushtrimin e profesionit, që përfshinë veprimet që kërkojnë sforcime me duar duke iu referuar profesionit, si dhe qëndrimin në këmbë, pozita të papërshtatshme dhe të detyruara të qafës gjatë punëve profesionale).

Me propozimin e palës paditëse, gjykata ka caktuar ekspertin e aktuaristikës dhe financave, për llogaritjen e fitimit të humbur gjatë kohës sa ka qenë i zvogëluar aktiviteti punues të paditësi dhe atë i përkohshëm për 3 muaj në shkallë prej 100%, për 6 muaj në shkallë prej 50% ndërsa pas kësaj periudhe në shkallë prej 10% e deri sa të ekzistojnë kushtet, eksperti aktuar Aziz Berisha, në ekspertizën e dt.15.11.2023, ku me rastin e llogaritjes së fitimit të humbur të paditësit ka marrë për bazë pagat mesatare të të punësuarve të pakualifikuar në Kosovë, pra aq sa ai së paku do të ekonomizonte po të mos aksidentohej konstatoi se paditësi si pasojë e lëndimeve të marra në aksidentin e komunikacionit të dt. 14.06.2020, përpos llojeve të tjera të dëmit ka pësuar edhe dëm material të formës së fitimit të humbur në shuma si: a) për periudhën e kaluar prej aksidentit (14.06.2020) e deri në ditën e përpilimit të ekspertizës (31.10.2023), në lartësi prej 3,592.00€, dhe b) për periudhën e ardhshme prej 01.11.2023, e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, renta e paditësit arrin në 40.53€ në muaj, e cila në formë të kapitalizuar arrinë vlerën prej 9,775.80€.

Eksperti i aktuaristikës A. B. në seancën e dt. 16.11.2023, në pyetjet e të autorizuarit të të paditurës ka deklaruar se përkundër asaj se e kishte të regjistruar biznesin me të njejtën veprimtari shumë pak ishte marrë dhe se porsa kishte filluar të mirret me të njejtat punë të berberit i kishte ndodhur aksidenti siq kishte thënë paditësi, pas së cilës datë fare s' ishte marrë me veprimtari për qka dhe nuk kishte arrit as të paguaj tatim ATK-së e as kontribute në trustin e kursimeve të tij pensionale siq shihet edhe nga pasqyra e tij e trustit të cilën në ndërkohë e kishte siguruar dhe pasi që paditësi ka thënë se detyrimisht është dasht që të mirret me punë fizike në ekonominë familjare në fshat ku edhe jeton me familje dhe mu pët këtë me rastin e llogaritjes së fitimit të tij të humbur ka marrë për bazë pagën mesatare të punëtorëve të pakualifikuar fizik në Kosovë dhe nga kjo bazë në proporcion të invaliditetit të tij punuesiq ekspertja e mjekësisë së punës ka vlerësuar invaliditetin e tij ka llogaritur rentën e tij mujore dhe gjithashtu fitimin e humbur. Ka shtuar se me rastin e llogaritjes së fitimit të humbur i njejt ka marrë për bazë pagën mesatare të punëtorëve të pakualifikuar fizik në Kosovë dhe jo paga minimale, pasi që paditësinë momentin e aksidentit ka qenë 29 vjeç pra ka qenë nën moshën 35 vjeçare, ashtu siq rekomandon edhe rregullorja e BQK-së.

*Gjendja faktike e vërtetuar.*

Gjykata vërtetoi se nuk ishte kontestuese baza e kërkesëpadisë, e të njejtën nuk e ka kontestuar as e paditura, si dhe e njejtja u vërtetua në bazë raportit të policisë nr.2020-AR-1064, të dt. 19.06.2020, nga i cili raport u vërtetua se me dt.14.06.2020, ka ndodhur aksident komunikacioni rrugor në mes të një mjetei bujqësor i tipit IMT 558 ku në atë kohë nuk ka qenë i siguruar, dhe automjetit ... me targa ..., ku deri te aksidenti kishte ardhur kur automjeti bujqësor A, ka ardhur nga drejtimi fsh. B., përgjatë rrugës P.. dhe kur vie në kryqëzim me rrugën H.P., i njejt nuk është ndaluar para shenjës "S.." dhe është kyçur në rrugë pa u siguruar mirë dhe e detyron automjetin B, që për mos ta goditur ky i fundit të dal në shiritin tjetër në të majtë e pastaj edhe jashtë rruge i cili pasi që nuk ka mundur ta ndalë automjetin, me pjesën e parë është goditur në shtyllën e hyrjes në barnatoren bujqësore "A.B.." në të cilin aksident tani paditësi F.A.ka është dërguar në QE – QKUK në P..ku edhe pas trajtimit mjekësor i mjejt ndalet për trajtim në Repartin e Maxilofaciales për shkak të lëndimeve të rënda.

Gjykata e mori në tërësi si të bazuar dhe ia dha besimin e plotë ekspertizave mjeksore të eksperteve të ortopedisë, kirurgut maksfacial dhe psikiatrisë, dhe ekspertizës së mjekësisë së punës së ekspertit A. T., si dhe ekspertizës të ekspertit të aktuaristikës A. B. , sa i përket llogaritjes së fitimit të humbur për paditësin, nga se ekspertizat i përmbanë elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.



Gjykata për paditësin në emër të dhimbjeve fizike e aprovoi kërkesën në shumë prej 6,500.00-€ dhe e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, dhe atë sipas mendimit të ekspertes mjekësore dr. V. B. ortoped-traumatolog e cila vlerëson se paditësi si pasojë e aksidentit ka pasur lëndime të cilat janë shoqëruar me: dhembje të intensitetit posaçërisht të rëndë për rreth një orë (duke marrë parasysh vendndodhjen e aksidentit, transportin dhe realizimin e ekzaminimeve klinike, radiologjike dhe marrjen e analgjetikëve në Qendrën Emergjente); dhembje të intensitetit të rëndë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 3 ditësh (e shprehur me dhembje në regjionin e fytyrës duke përfshirë edhe intervenimin kirurgjikal në kockat e fytyrës); dhembje të intensitetit të mesëm për 28 ditë të tjera (që përfshinë priudhën e ramjes së edemës dhe hematomës në regjonet e kockave të thyera); si dhe dhembje të intensitetit të ulët që i posedon ende në hapkë të gojës dhe ndërrime klimatike.

Në emër të frikës së pësuar gjykata e ka aprovuar shpërblimin në shumë prej 5,500.00-€ dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se, sipas mendimit të ekspertes mjekësore të psikiatrisë dr. S. B., paditësi ka pësuar frikë primare në kohëzgjatje prej disa sekonda në momentin e aksidentit e prezentuar në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimit direkt për integritetin e tij trupor, frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur 24orë që është manifestuar me simptome të ankthit të gjeneralizuar, frikë nga invaliditeti, çrregullim gjumi, rikujtime të shpeshta të ngjarjes dhe simptome përcjellëse të reagimit akut ndaj stresit, frikë sekondare me intensitet mesatar dhe të ulët që ka zgjatur 3 deri në 4 muaj e manifestuar me reagim eemocionale të karakterit ansioz, zgjime të herë pas hershme gjatë gjumit me rikujtime të ngjarjes traumatike si dhe frikë të intensitetit të ulur të cilën e ka sot e kësaj dite e shoqëruar me pasiguri ndër pjesëmarrje në komunikacion.

Dhimbjet shpirtërore për shëmtim trupor gjykata aprovoi shumën prej 3,500.00 €, duke e vlerësuar si shpërblim të drejtë bazuar këtë në mendimin e dhënë nga eksperti mjekësor , e cila ka vlerësuar se te paditësi ekziston shëmtimi i shkallës së mesme.

Në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetesor, gjykata ia njohu të drejtën në shpërblim në shumën prej 5,000.00-€, duke e vlerësuar si shpërblim të drejtë, këtë duke e vlerësuar dhe atë bazuar në mendimin e dhënë nga eksperti gjyqësor nga mjekësia e punës dr.A.. T., i cila ka vlerësuar se paditësi ka zvogëlim të aktivitetit të perhershëm të punës në shkallë prej 10%.

Sa i përket dëmit material në emër të ndihmës dhe përkujdesit nga personi tjetër gjykata e pati parasysh mendimin e ekspertes mjekësore të ortopedisë dr. V.B..., ashtu që për ndihmën dhe përkujdesin e personit të tretë në kohëzgjatje prej 2 javësh, gjykata duke e llogaritur pagën minimale në Kosovë e cila është në lartësi prej 170.00-€, dhe paditësit i është nevojitur ndihma

dhe përkujdesi nga personi i tretë në kohëzgjatje prej 2 javësh atëherë gjykata vlerësoi shumën prej 108.08-€ për këtë periudhë kohore.

Në emër të ushqimit të përforcuar gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 227.50-€, duke u nisur në baza ditore të cilën gjykata e llogariti në shumë prej 6.50€ në ditë, ashtu që sipas mendimit të ekspertit të ortopedisë të njëjtit i është nevojitur ushqimi i përforcuar në kohëzgjatje prej 5 javësh, dhe atë për ushqim të pasur me proteina, minerale, vitamina më shumë se ushqimi i zakonshëm dhe ushqim i posaçëm i lëngshëm për shkak të plagëve në gojë.

Në emër të shpenzimeve për shërim gjykata ia njohu shpenzimet në shumë prej 831.50€, e kjo bazuar në provat materiale kuponat fiskaldhe parashtresën për precizimin e kërkesëpadisë.

#### *Baza ligjore*

Gjykata, nisur nga konstatimi i gjendjes faktike të përshkruar si më lart, gjeti se paditësit duhet zhdëmtuar mbi bazën e përgjegjësisë, në bazë të nenit 159, par. 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 në të cilin thuhet “*Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit*”.

Gjykata, lidhur me lartësinë e kompensimit të caktuar si në pikën I të dispozitivit, i'u referua dispozitave mbi kompensimin e dëmit material dhe jo material të përcaktuara në nenin 169 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 në të cilin thuhet” *Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla*”, ndërsa në par.2 të këtij neni parashihet “*Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror*

#### *Vlerësimi përfundimtar i gjykatës*

Prandaj, gjykata, nisur nga arsyet e cekura ligjore, mbi bazën e vërtetuar të gjendjes faktike, gjeti se paditësit i takon kompensimi i dëmit material dhe jo material si në pikën I të dispozitivit, duke vlerësuar se shumtë e gjykuara janë të mjaftueshme, koherente me natyrën, kohëzgjatjen, intensitetin e dëmeve materiale dhe jomateriale që paditësi ka pësuar në aksident komunikacioni për të gjitha kategoritë e dëmeve.

Lidhur me kamatën e aplikuar, gjykata iu referua nenit 382, par.1 të LMD-së në të cilin përcaktohet detyrimi i debitorit që vonon përmbushjen e detyrimit në të holla dhe lartësia e kamatëvonesës ku përcaktohet “*Debitori që vonon në përmbushjen detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën*”, ndërsa rrjedhjen e kësaj kamate e përcaktoi në dy

periudha kohore, duke marrë për bazë edhe praktikën gjyqësore, ku përcaktohet se për dëmin jomaterial kamatëvonesa rrjedh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa kamatëvonesa për dëmin material rrjedh nga koha e ushtrimit të padisë në rastin konkret.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese respektivisht shumës mbi shumat e aprovuara, gjykata të njëjtat i refuzoj nga se konsideroj se shuma e kërkuar mbi shumën e aprovuar është mbi shumën e cila nevojitet që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet aty ku do të ishte po mos të kishte ndodhur veprimi dëmtues.

Gjykata, lidhur me pjesën refuzuese sipas kërkesëpadisë nga pika **III** e dispozitivit, iu referua provave në shkresat e lëndës, natyrës, kohëzgjatjes dhe intensitetit të lëndimeve dhe dëmeve të pësuar nga paditësi, standardit shoqëror në të cilin jeton paditësi, praktikës gjyqësore në rastet e aplikimit të këtij dëmi, ashtu që, gjeti se shuma e refuzuar si në këtë pikë nuk mund të argumentohet dhe me aprovimin eventual të saj, gjykata do të vuhej në shërbim të keqpërdorimit me qëllime lukrative të paditësit dhe palëve të autorizuara për tu zhdëmtuar në shpërpjesëtim të hapur me dëmet e pësuar.

Gjykata në këtë rast ka vlerësuar edhe thëniet e palës së paditur ku e njëjta nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë, por vetëm e ka kontestuar lartësinë e kërkesëpadisë së precizuar, mirëpo me as një provë nuk është argumentuar e kundërta nga ajo që është në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe me arsyetimet e dhëna më lart.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat e neneve 449 dhe 452 të LPK-së, dhe atë: në emër të përpilimit të padisë shumën prej 208.00-€, në emër të parashtresës për precizimin e lartësisë së kërkesëpadisë shumën prej 208.00€, për pjesëmarrje në seanca, për 5 seanca të mbajtura shumën prej (nga 270.40 € x 5 seanca = 1,352.00. €), për përfaqësim në 4 seanca të shtyera shumën prej (nga 135.20 € x 4 seanca = 540.80) €, të gjitha këto shuma sipas TOAK-ës, për ekspertizën e komunikacionit shumën prej 150.00€, për ekspertizën mjekësore shumën prej 450.00€, për ekspertizën nga mjekësia e punës shumën prej 120.00€, për ekspertizën aktuaristike shumën prej 150.00€, si dhe për taksë gjyqësore për padi shumën prej 100.00-€.

Mbi bazën e të lartshënuarave u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN**

**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**

**C.nr.887/20, datë 05.12.2023.**

**G J Y Q T A R I**

Zenel Tasholli

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Numri i lëndës: 2020:139632  
Datë: 08.03.2024  
Numri i dokumentit: 05427653

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh prej ditës së pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.